

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIIONIN

2.2.1.2 Vazhdim i rishikimit të llogarive kombëtare sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve (me fokus në Llogaritë Kombëtare Tremujore)

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Clementina Ivan-Ungureanu,
Statistikat e Danimarkës

9-20 Shkurt 2015

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu

Statistics Denmark

Sejrøgade 11

DK-2100 Copenhagen Ø

Denmark

Tel: +

Email: clementina@ivan-ungureanu.ro

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	6
2. Vlerësimi dhe rezultatet	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
2.1 BPVT i tremujorit të dytë të vitit 2014	6
2.2 Harta rrugore	8
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	9
Aneksi 1 TeR.....	10
Aneksi 2. Programi, 8-20 Shkurt 2014.....	13

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Vjetore Kombëtare
BoPs	Bilanci i Pagesave
BPM6	Bilanci i pagesave dhe Manuali i Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, edicioni i gjashtë
BEC	Kategoritë e Mëdha Ekonomike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
SHKF	Shpenzimet e Kapitalit Fiks
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
FBKF	Formimi Bruto Kapitalit Fiks
KFQ	Konsumi Final i Qeverisë
SHKFEF	Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare
IC	Konsumi i Ndërmjetëm
IÇIM	Indeksi i Çmimeve të Importit
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
TI	Teknologjia Informatike
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MoU	Memorandum i Mirëkuptimit

LLK	Llogartië Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
NPISH	Institucionet Jo-profitabile në Shërbim të Ekonomive Familjare
NOE	Ekonomia e pavrojtuar
OJQ	Organizatrat Jo Qeveritare
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
SIDA	Agjencioni Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
STS	Statistikat Afat-Shkurta
SUT	Tabelat Ofruse-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje ekzekutive

Objektiv kryesor i misionit aktual, në kuadër të komponentit 2 – Llogaritë kombëtare- të Projektit të Binjakëzimit, ka qenë vazhdimi i përkrahjes teknike për Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) në fushën e vlerësimit të BPV-së tremujore (BPVT). Janë analizuar vlerësimet e BPVT-së për tremujorin e dytë të vitit 2014 dhe janë ofruar rekomandimet për përmirësimet e nevojshme. Gjatë misionit, kanë filluar edhe vlerësimet e BPV-së për tremujorin e tretë; vlerësimet e para sipas qasjes së prodhimit, në çmime aktuale dhe konstante, kanë qenë në dispozicion në fund të misionit.

Në vitin 2014, ASK ka implementuar BPVT-në sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve në kuadër të kornizës së projektit IPA 2011 dhe me përkrahjen teknike nga Projekti i Binjakëzimit. Janë krijuar seritë kohore për vitet 2010-2013 bazuar mbi të dhënat vjetore dhe të dhënat statistikore dhe burimet e të dhënave statistikore në dispozicion. Misionet e kaluara në kuadër të projektit të binjakëzimit (1-5 Dhjetor të vitit 2014) kanë përkrahur ASK-në në publikimin për herë të parë të BPVT-së për periudhën 2010 – tremujori i parë i vitit 2014, në çmimet aktuale dhe konstante, sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve.

Gjatë këtij misioni, janë analizuar dhe finalizuar vlerësimet e BPV-së për tremujorin e dytë të vitit 2014 sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, me fokus në balancimin e dy qasjeve. Vlerësimet janë bërë në bazë të burimeve të të dhënave statistikore dhe administrative në dispozicion: qarkullimi i siguruar nga Administrata Tatimore, pasqyrat financiare të njësisë financiare (Banka Qendrore, bankat e tjera komerciale dhe kompanitë e sigurimit), qarkullimet tremujore të disa industrive (minierave, prodhimit dhe energjisë), IÇP, IÇK, outputi i bujqësisë dhe çmimet e inputeve. Cilësia e vlerësimeve tremujore të BPV-së varet nga burimet e të dhënave që janë në dispozicion dhe besueshmëria e tyre. Në Kosovë ka mungesë të të dhënave statistikore dhe administrative në baza tremujore: ka informata në lidhje me bujqësinë, ndërtimtarinë, shërbimet, prodhimin, investimet dhe ndryshimet në inventar. Të dhënat e disa industrive mbi qarkullimin, të ofruara nga Administrata Tatimore, kishin një dallim të madh midis tremujoreve të vitit 2014 dhe në krahasim me vitin e kaluar (2013). Për këtë arsye rekomandohet që ASK në një të ardhme të afërt të mundohet të përmirësojë statistikën afat shkurt (STS) dhe të rrisë bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Administratën Tatimore në mënyrë që të dhënat në dispozicion të jenë sa më cilësore.

Vlerësimet e BPV-së për tremujorin e tretë të vitit 2014 kanë filluar gjatë misionit aktual dhe rezultatet e para pritet të jenë në dispozicion në fund të misionit. ASK duhet të finalizojë vlerësimin e konsumit final të qeverisë (KFQ) dhe formimin bruto të kapitalit fiks (FBKF) deri në Prill, kur planifikohet diseminimi i BPV-së për tremujorin e tretë.

Është diskutuar në lidhje me përmbajtjen e konferencës për shtyp për BPVT – tremujorin e dytë; është rekomanduar që të përfshihet edhe BPVT e vitit 2013, në çmime aktuale, sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve dhe dy tremujorëve në dispozicion të vitit 2014, në çmime aktuale dhe konstante.

Është diskutuar me menaxhmentin dhe stafin e Departamentit të Llogarive Kombëtare (DLLK), harta rrugore për vlerësimin dhe diseminimin e BPVT-së. Për shkak se vlerësimi i bilancit të pagesave (BoPs) tani bazohet në Bilancin e Pagesave dhe Manualin e investimeve ndërkombëtare, edicioni i gjashtë (BPM6), rishikimi i serive kohore në tërësi për vitet 2010-2014, për llogaritë vjetore dhe tremujore duhet të realizohet deri në Qershor të vitit 2015. ASK duhet të zvogëlojë hapësirën kohore të diseminimit të BPV-së tremujore; tremujori parë i vitit 2016 do të jetë në dispozicion 80-90 ditë pas përfundimit të periudhës referuese. Rekomandohet të bëhet një strategji për rishikimin e BPVT-së tremujore dhe të informohen përdoruesit.

1. Komentet të përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat.

Objektivat e këtij misioni ishin përkrahja e ASK-së në vlerësimin e BPVT-së për tremujorin e dytë të vitit 2014 dhe elaborimi i hartës rrugore për ciklin e prodhimit për BPV-në Tremujore sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante. Gjatë këtij misioni, përveç objektivave të propozuara, po ashtu janë realizuar edhe vlerësimet e BPVT-së për tremujorin e tretë të vitit 2014.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përpunohen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve të tjerë (NI-CO/Statistikat e Finlandës/Istat/Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimet dhe rezultatet

2.1 BPVT i tremujorit të dytë të vitit 2014

Vlerësimet e BPVT-së për tremujorin e dytë të vitit 2014 janë realizuar me metodologjinë e aplikuar për tremujorin e parë duke përdorur burimet e njejta të të dhënave.

Në sektorin e bujqësisë ka mungesë të madhe të të dhënave tremujore. ASK ofron vetëm çmimet mujore të bujqësisë (për outputet dhe inputet) për prodhim dhe prodhim për kafshët. Nga Ministria e Bujqësisë janë marrë informata në lidhje me sipërfaqen e mbjellur në pranverë dhe në vjeshtë. Vlerësimi i outputit është bërë duke supozuar që vëllimi i prodhimit është në korrelacion me sipërfaqen e mbjellur. Agjencioni i Veterinarisë ka ofruar informata në lidhje me numrin e kafshëve për vitin 2013 dhe 2014; outputi tremujor është vlerësuar në bazë të supozimit që shkalla e rritjes vjetore e numrit të kafshëve është e njejte për të gjithë tremujorët.

Outputi i njësive jo-financiare që mbulon minierat, prodhimin dhe shërbimet e tregut, është vlerësuar duke u bazuar kryesisht në të dhënat e qarkullimit të ofruara nga Administrata Tatimore. Duhet të theksohet që të dhënat nga Administra Tatimore menaxhohen nga një person i vetëm, që i përket departamentit ekonomik; pra, në mënyrë që të përdoren këto të dhëna për llogaritë kombëtare ose të analizohen ato, duhet bërë kërkesë speciale dhe kjo procedurë merr kohë. Analizimi i të dhënave në tremujorët e parë të vitit 2013 dhe 2014 nxjerr në pah një mospërputhje midis të dhënave. Për shembull, qarkullimi i njësive të klasifikuara në prodhimin e ushqimit dhe pijeve në tremujorin e dytë dhe të tretë të viti 2014 është pothuajse përgjysmë në krahasim me tremujorët korresponduese të vitit 2013; vlera e qarkullimit në aktivitetin e tregtisë është ulur për 180 milion në tremujorin e tretë të vitit 2014 në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2013. Për këtë arsye, ekspertja ka propozuar të analizohen 10 kompanitë më të mëdha prej secilit kod NACE, por të dhënat e ofruara nuk e kanë mundur shpjegimin e këtyre mospërputhjeve. Përfundimisht, outputi është vlerësuar për disa industri, bazuar në shkallën e rritjes dhe PPI dhe IÇK korresponduese, kurse për industrinë e tjera bazuar në indeksin e qarkullimit, të siguruar nga Departamenti Ekonomik i ASK-së. Konsumi i ndërmjetëm është vlerësuar, duke përdorur raportin e njëjtë të I/O si të tremujorët korrespondues të vitit të kaluar.

Outputi i ndërtimtarisë është vlerësuar duke aplikuar metodologjinë e vlerësimit vjetor, bazuar mbi metodën e inputit. Aktiviteti financiar në baza tremujore është vlerësuar bazuar në të dhënat mujore të ofruara nga Banka Qendrore duke aplikuar metodologjinë e njëjtë si në kalkulimet vjetore. Vlerat konstante janë vlerësuar duke përdorur IÇK-në korresponduese. FISIM është kalkuluar duke aplikuar metodologjinë vjetore dhe është alokuar te përdoruesit. Outputi i shërbimeve qeveritare është vlerësuar bazuar në qasjen e kostos, duke përdorur informatat e detajuara nga Ministria e Financave. Nga analizimi i të dhënave vërehet një evoluim i ndryshëm i pagave përgjatë tremujorëve; në tërë seritë kohore, vlerat e pagave në tremujorin e katërt pothuajse janë dyfishuar në raport me tremujorin e parë dhe me 40% më shumë se në tremujorin e dytë dhe të tretë. Për shkak të mungesës së shpjegimeve nga Ministria e Financave, të dhënat janë përfshirë në vlerësime, pa ndonjë rregullim paraprak. Konsumi Tremujor i Kapitalit Fiks është vlerësuar bazuar në shkallën e rritjes së formimit bruto të kapitalit fiks (FBKF) të qeverisë dhe IÇP-së korresponduese.

Outputi tremujor i NPISHs është vlerësuar duke përdorur të njëjtën metodologji si në tremujorin e parë të vitit 2014, bazuar mbi IÇK-në korresponduese dhe duke marrë në konsideratë shkallën e rritjes reale në të njëjtin nivel me vitin e kaluar.

Vlerësimi i taksave dhe subvencioneve mbi prodhimet është bërë duke aplikuar metodologjinë vjetore. Nga analizimi i të dhënave shihet një vlerë e madhe e subvencioneve për tremujorin e dytë të vitit 2014; për shkak se nuk ka pasur informata të detajuara në lidhje me destinacionin e subvencioneve, dhe si rezultat pamundësia e klasifikimit të tyre në subvencione mbi produktet ose prodhimin, në vlerësimin e BPV-së së tremujorit të dytë, ka bërë të përfshihen vetëm subvencionet për bujqësi.

Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare (SHKFEF) janë vlerësuar bazuar mbi qasjen e qarkullimit të mallit. Kalkulimet janë bërë për këto kategori të mëdha të konsumit: Konsumi i mallrave nga aktiviteti i tregtisë; Konsumit të mallrave të bujqësisë nga prodhimi vetanak; Hotelet dhe restorantet; Transportit; Shërbimeve Financiare (përfshirë FISIM dhe sigurimin) dhe shërbimet e tjera (shëndetësia, edukimi dhe shërbimet e tjera për popullsinë). SHKFEF në çmime konstante është vlerësuar nga deflacioni, duke përdorur IÇK-në korresponduese.

Për vlerësimet e tremujorit të FBKF-së është aplikuar metodologjia vjetore dhe është bazuar në të dhënat e importit (më shumë detaje janë paraqitur në raportin e misionit të mbajtur në Qershor dhe Gusht të vitit 2014).

Për shkak që Banka Qendrore e Kosovës ka ndryshuar metodologjinë, rishikimi i të dhënave tremujore mbi importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve është realizuar bazuar në Bilancin e Pagesave dhe Manualin e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, edicioni gjashtë (BPM6).

Mos përputhjet midis këtyre dy qasjeve nuk kanë qenë të mëdha, më pak se 3%; rregullimet janë bërë kryesisht për qasjen e shpenzimeve, në SHKFEF dhe ndryshimet në inventar.

Gjatë misionit, është diskutuar përmbajtja e konferencës për shtyp për BPVT – tremujorin e dytë. Bazuar në eksperiencën prej vendeve tjera, është rekomanduar të prezantohen komponentet e BPV-së sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve në çmime aktuale dhe konstante për dy tremujoret në dispozicion të vitit 2014.

2.2 Harta rrugore

Vlerësimet e BPVT-së në Kosovë kanë filluar në kuadër të kornizës së projektit IPA (2012 – Mars 2014); publikimi i parë i serisë kohore 2010 – tremujori i parë i vitit 2014 të BPVT-së, sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante është diseminuar në Dhjetor të vitit 2014, me përkrahjen e projektit të binjakëzimit.

Këtë vit, ASK ka për objektiv diseminimin e tremujoreve II, III dhe IV të vitit 2014 dhe të dy tremujoreve të parë të vitit 2015 (tremujori I në Gusht dhe tremujori i II në Nëntor 2015). Pasi implementimi i BPV-së tremujore është një detyrë e vështirë, është normale të ketë hapësirë në mes të publikimeve të të dhënave dhe periudhës referuese. Për dy tremujoret e parë të vitit 2015, vonesa është afërsisht 5 muaj, ndërkohë që rregulloret Evropiane mbi llogaritë kombëtare kërkojnë diseminimin e të dhënave tremujore brenda 2 muajsh pas përfundimit të periudhës.

Është bërë një analizë e disponueshmërisë të burimeve të të dhënave administrative dhe statistikore. Burimi kryesor i përdorur për BPVT-në sipas prodhimit është Administra Tatimore dhe paraqet qarkullimin e ndërmarrjeve për TVSH. Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, nënshkruar nga ASK dhe Administrata Tatimore, të dhënat ofrohen 60 ditë pas përfundimit të tremujorit referues. Menaxhmenti dhe stafi i DLLK-së janë pajtuar me këtë

propozim dhe duke filluar me tremujorin e parë të vitit 2016 do të bëhet një kalendar i ri diseminimi për BPVT-në.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Implementimi i BPVT-së të vitit 2014 paraqet një prej përmirësimeve kryesore në fushën e llogarive kombëtare. Këtë vit, ASK ka si objektiv kryesor të reduktojë hapësirën kohore të vlerësimeve të BPVT-së dhe, nëse e mundur, nga viti 2016 të fillohet me publikimin e të dhënave 90 ditë pas përfundimit të periudhës referuese.

Akoma vlejné rekomandimet e dhëna gjatë misionit të dhjetorit 2014 për përmirësimin e BPVT-së. Aktualisht, janë dhënë edhe këto rekomandime shtesë:

- Analizimi i të ardhurave qeveritare dhe shpenzimeve për një klasifikim korrekt në konceptet e llogarive kombëtare, bazuar në kërkesat metodologjike të ESA 2010. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet për klasifikimit të taksave dhe subvencioneve mbi produktet, me ndikim në nivelin e BPV-së.
- Rishikimi i tërë serive kohore të BPVT-së, për shkak të implementimit të BPM6. Vlerësimi i eksportit dhe importit të mallrave në çmime konstante duhet të rishikohet dhe përmirësohet.
- ASK ka përmirësuar statistikën afat shkurta (STS); janë vlerësuar dhe diseminuar indekset e qarkullimit tremujor për minierat, prodhimin dhe energjinë. Është rekomanduar të analizohet cilësia e vlerësimit në mënyrë që të përmirësohen ato.
- Vlerësimet e BPVT-së për vitin 2014 konsiderohen si të përkohshme; të dhënat vjetore (që do të jenë në dispozicion në Nëntor të vitit 2015) do të përdoren për të standardizuar vlerësimet tremujore. Është rekomanduar të elaborohet strategjia për rishikimin e BPVT-së dhe të informohen përdoruesit.

Aneksi 1 Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.2.1.2: Vazhdimi i rishikimit të llogarive kombëtare sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve (me fokus në Llogaritë Kombëtare Tremujore)

Afatet:

Ter –data e finalizimit: 26 Janar 2015

Fillimi / fundi i aktivitetit: 9-20 Shkurt 2015

Koha e raportimit: 28 Shkurt 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.2.1.2	Rishikimi i llogarive kombëtare sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve	Raporti i Misionit, ku përshkruhet puna e realizuar dhe që duhet të realizohet para aktivitetit të radhës, i publikuar në web faqen e projektit	Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit Raportet e Misionit Plani veprues i azhurnuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i i nvolvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e

		Llogaritë kombëtare vjetore, të rishikuara		detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve • Qasje në statistika primare të qarta • Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, aktivitetet dhe agjendën
--	--	--	--	--

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.2.1.2

Ky mision është vazhdim i misionit 2.3.1.2 që është mbajtur në Dhjetor të vitit 2014

Në Dhjetor të vitit 2014 ASK ka publikuar, për herë të parë, BPV-në tremujore për Kosovë për periudhën 2010- tremujori i I 2014. Ky mision është fokusuar në vazhdimin e procesit të ciklit të prodhimit për këto statistika dhe vlerësimet e tremujorit të dytë të vitit 2014, që është planifikuar të publikohet në fund të Shkurtit (25 Shkurt 2015).

Gjatë misionit, ekspertja do të ketë edhe më tutje konsultime dhe diskutime me njësinë e Llogarive Kombëtare.

Harta rrugore për Llogaritë Kombëtare, tabela 2, nga aktiviteti 2.1.1 (Vlerësimi dhe azhurnimi i Planit Veprues) nga Graversen dhe Ungureanu, paraqet në detaje një numër hapash të nevojshëm. Plani i punës, i përgatitur vitin e kaluar nga ASK, dhe i aprovuar nga Qeveria, parasheh vlerësimin e BPV-së tremujore sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante në baza të rregullta dhe reduktimin e vonës në diseminimin e këtyre të dhënave.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.2.1.2

Raporti i misionit.

Harta rrugore për ciklin e prodhimit për Llogarinë Kombëtare Tremujore

Përkrahja e ASK-së për vlerësimin e BPV-së tremujore sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve për tremujorin e dytë të vitit 2014.

Trajnimi në vendin e punës mbi vlerësimin e llogarive tremujore.

Stafi i ASK:

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, xhevriefetahu@gmail.com, ASK

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, ilir.mazrekaj@gmail.com

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, alzana76@gmail.com

Florije Krapit, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapit@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, nysretsylejmani8@gmail.com

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Znj. Clementina Ivan-Ungureanu, Eksperte, Statistikat e Danimarkës, clementina@ivan-ungureanu.ro

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaroi në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK, me mbështetjen e IPA, ka përgatitur një Plan të veprimtë për përpilimin dhe publikimin e statistikave të plota për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

AGA më tej deklaroi që në parim përmirësimet dhe rritja e mbulueshmërisë së Llogarive Kombëtare vjetore duhet të jenë prioritet për ASK-në. Kalkulimi i BPV-së duke përdorur qasjen sipas prodhimit dhe shpenzimeve është me rëndësi të veçantë në këtë drejtim.

Aktivitetet e pritura janë:

- Përkrahja e ASK-së për vlerësimin e BPV-së tremujore sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve për tremujorin e dytë të vitit 2014. Diskutimet mbi ciklin e prodhimit të Llogarive Kombëtare Tremujore.

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas mostrës
- Rekomandimet për aktivitetet e më tej për të siguruar arritjen e qëllimeve të vlerësimit të BPV-së tremujore sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve

Aneksi 2. Programi, 8-20 Shkurt 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09.00	Planifikimi i javës
		09:30	Aktivitetet që janë zhvilluar që nga misioni i fundit
		10:30	Pauza për kafe
		11:00	Grumbullimi dhe analizimi i burimeve të të dhënave për vlerësimin e BPVT, tremujorit të II të vitit 2014 sipas qasjes së prodhimit
		12:00	Dreka
		13:10	Grumbullimi dhe analizimi i burimeve të të dhënave për vlerësimin e BPVT, tremujorit të II të vitit 2014 sipas qasjes së prodhimit-vazhdim
		14:30	Pauza për kafe
		15:00	Grumbullimi dhe analizimi i burimeve të të dhënave për vlerësimin e BPVT, tremujorit të II të vitit 2014 sipas qasjes së prodhimit-vazhdim
		16:30	Konkluzionet preliminare
2	ASK	09:00-12.00	Grumbullimi dhe analizimi i burimeve të të dhënave për vlerësimin e BPVT, tremujorit të II të vitit 2014 sipas qasjes së shpenzimeve
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Grumbullimi dhe analizimi i burimeve të të dhënave për vlerësimin e BPVT, tremujorit të II të vitit 2014 sipas qasjes së shpenzimeve-vazhdim
3	ASK	09:00-12.00	Grumbullimi dhe analizimi i indekseve të çmimit i nevojshëm për vlerësimin e BPVT në çmime konstante
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Grumbullimi dhe analizimi i indekseve të çmimit i nevojshëm për vlerësimin e BPVT në çmime konstante-

			vazhdim
4	ASK	09:00-12.00	Vlerësimi i BPVT, tremujori I II I vitit 2015, sipas qasjes së prodhimit në çmime aktuale dhe konstante
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2015, sipas qasjes së prodhimit në çmime aktuale dhe konstante-vazhdim
5	ASK	09:00	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2015, sipas qasjes së prodhimit në çmime aktuale dhe konstante-vazhdim
		10:30	Pauza për kafe
		10:00	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2015, sipas qasjes së prodhimit në çmime aktuale dhe konstante-vazhdim
		12:00	Dreka
		13:15-17.00	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2015, sipas qasjes së prodhimit në çmime aktuale dhe konstante-vazhdim
6	ASK	09.00	Planifikimi i javës
		10:30	Pauza për kafe
		11:00	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2014, sipas qasjes së shpenzimeve në çmime aktuale dhe konstante
		12:00	Dreka
		13:10	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2014, sipas qasjes së shpenzimeve në çmime aktuale dhe konstante
		14:30	Pauza për kafe
		15:00	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2014, sipas qasjes së shpenzimeve në çmime aktuale dhe konstante
		16:30	Konkluzionet preliminare
7	ASK	09:00-12.00	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2014, sipas qasjes së shpenzimeve në çmime aktuale dhe konstante
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Vlerësimi i BPVT, tremujori i II i vitit 2014, sipas qasjes së shpenzimeve në çmime aktuale dhe konstante
8	ASK	09:00-12.00	Balancimi i BPVT sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Balancimi i BPVT sipas qasjes së prodhimit dhe

			shpenzimeve-vazhdim
9	ASK	09:00-12.00	Balancimi i BPVT sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve-vazhdim
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Analizimi i vlerësimeve finale të BPVT, tremujori i II i vitit 2014
10	ASK	09:00	Drafti i publikimit të BPVT
		10:30	Pauza për kafe
		10:00	Drafti i publikimit të BPVT-vazhdim
		12:00	Dreka
		13:15-17.00	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA